REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 127/17
Datë/Datum. 29.05.17
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH.nr. 127/17

PANELI SHQYRTUES I PROKURIMIT PUBLIK, i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje Z. Ekrem Salihu - Kryetar, Z. Nuhi Paçarizi - Referues, Z. Blerim Dina - Anëtar duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik "Er-Lis&Ve-Mor sh.p.k"-Pejë, lidhur me anulimin e aktivitetit të prokurimit me titull "Mirëmbajtja e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit, pastrimi i rrugëve, ujitja e hapësirave publike dhe transporti i mbeturinave" me nr. prok. 6120/16/097/221, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues KK-Fushë Kosovë,në seancën e datës: 24.05.2017 mori këtë:

V E N D I M

I. **Aprovohet**, si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik "Er-Lis&Ve-Mor sh.p.k"-Pejë lidhur me aktivitetin e prokurimit titull "Mirëmbajtja e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit, pastrimi i rrugëve, ujitja e hapësirave publike dhe transporti i mbeturinave" me nr. prok. 6120/16/097/221, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues KK- Fushë Kosovë.

II. **Anulohet,** njoftimi për anulim i autoritetit kontraktues KK-Fushë Kosovë, lidhur me aktivitetin të prokurimit, me titull: "Mirëmbajtja e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit, pastrimi i rrugëve, ujitja e hapësirave publike dhe transporti i mbeturinave" me nr. prok. 6120/16/097/221, dhe lënda kthehet në **Ri vlerësim**.

III. Autoriteti Kontraktues në aftë prej **10** ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit .

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të LPP-së nr.04/L-042, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se pretendimet ankimore të operatorit ekonomik ankues "Er-Lis&Ve-Mor sh.p.k"-Pejë, janë të qëndrueshme, i kthehet tarifa e sigurimit të ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Njoftimi për kontratë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit është bërë me dt:28.12.2016.

Hapja e ofertave është bërë me dt:18.01.2017, ku kanë marr pjesë dy operator ekonomik.

Njoftimi për anulim të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit është bërë me dt:06.04.2017

Kundër njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit, operatori ekonomik Er-Lis&Ve-Mor sh.p.k"-Pejë me dt:11.04.2017, ka bërë kërkesë për rishqyrtim tek autoriteti kontraktues.

Me dt:13.04.2017 autoriteti kontraktues ka marr vendim që të refuzohet si e pa bazuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Er-Lis&Ve-Mor sh.p.k"- Pejë

Operatori ekonomik ankues "Er-Lis&Ve-Mor sh.p.k"-Pejë, si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me 24 Prill 2017 me nr. 127/17 kundër njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit "Mirëmbajtja e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit, pastrimi i rrugëve, ujitja e hapësirave publike dhe transporti i mbeturinave" me nr. prok. 6120/16/097/221, të zhvilluar nga Autoriteti Kontraktues KK / Fushë Kosovë /, duke pretenduar se autoriteti kontraktues, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, ka bërë shkelje të këtyre dispozitave të LPP-së. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, me Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, siç janë:

Neni 62, i LPP-së, paragrafi 2.1 dhe 2.2, (Përfundimi i aktivitetit të prokurimit) , Neni 105, paragrafi 2.16 i LPP-së(Kompetencat e OSHP-së),

Interpretimi i KRRP lidhur me gabimet e mundshme të TVSH-së Faqja zyrtare e KRPP-pyetjet e shpeshta –Nr 46.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë 04.05.2017 ka autorizuar ekspertin shqyrtues, për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti Shqyrtues në raportin e dt: 12.05.2017 duke u mbështetur në vlerësimet e lartë cekura, i rekomandon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të hedhet poshtë si e palejuar, për këtë aktivitet të prokurimit dhe njëherit të detyrohet Autoriteti kontraktues KK Fushë Kosovë, që të respektoj vendimin e PSH.48/17 të dt. 23.03.2017 në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit: "Mirëmbajtja e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit, pastrimi i rrugëve, ujitja e hapësirave publike dhe transporti i mbeturinave, me nr. prokurimi:6120/16/097/221 të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Fushë Kosovë.

Operatori ekonomik ankues përmes përgjigjes me shkrim të dt:16.05.2017, ka njoftuar Panelin shqyrtues se nuk pajtohen me raportin e ekspertit shqyrtues

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 24.05.2017, e cila është mbajtur pa praninë e palëve konform nenit 28.1 të Rregullores së Punës së OSHP-së, u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për anulimin e aktivitetit të prokurimit, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit të OSHP-së, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë eksperti shqyrtues deklaroj: Pretendimet ankimore si dhe përgjigjet në pretendime ankimore i gjeni detajisht të përshkruara në raportin e ekspertizës se datë:12.05.2017. I rekomandoj panelit shqyrtues që ta aprovoj ankesën e OE. ankues si të bazuar dhe lëndën ta kthej në Rivlerësim

Në fjalën përfundimtare eksperti shqyrtues z.Basri Fazliu deklaroj;" qëndroj në tërësi pranë raportit të ekspertizës, si dhe pranë konstatimeve dhe rekomandimeve të dhëna në raportin e datës 12.05.2017".

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke pasur parasysh raportin e ekspertit shqyrtues, përgjigjet e palëve në procedurë vjen në përfundim se autoriteti kontraktues me rastin e ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve si dhe me rastin e anulimit të këtij aktiviteti të prokurimit, nuk e ka respektuar vendimin e panelit shqyrtues nr.48,58/17 të dt:23.03.2017, për faktin se në këtë vendim është sqaruar dhe cekur që autoriteti kontraktues pa të drejtë e ka eliminuar operatorin ekonomik ankues "Er-Lis&Ve-Mor sh.p.k"-Pejë në lidhje me normën e TVSH-së të ofruar për pozicionet e çmimeve nr.13,14,15,16,18,19,20,21 dhe 22 dhe njëkohësisht është konstatuar se autoriteti kontraktues nuk e ka respektuar edhe nenin 59 paragrafi 4 të LPP-së. Prandaj obligohet autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit të respektojë vendimin e panelit shqyrtues nr. 48,58/17 të dt:23.03.2017 dhe njëkohësisht të respektojë nenin 56 dhe 59 të LPP-së.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

z. Ekrem SALIHU

REPUBLIKA E KOSOVËS ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT PRISHTINË REPUBLIKA KOSOVA

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – KK - Fushë Kosovë

1x1 OE Er-Lis&Ve-Mor sh.p.k"-Pejë,

1x1 Arhivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së.